



# RAPORT MONITORIMI I KONTRATËS SOCIALE NDËRMJET KOMUNITETEVE DHE BASHKISË SHKODER

NËNSHKRUAR ME 05/12/ 2015




MAJ, 2017

Ky raport u përgatit nga Qendra e Gruas 'Hapa të Lehtë' me mbështetjen e Lëviz Albania. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo qëndrimet e entit financues.

## HYRJE

Raport- Monitorimi i Kontratës Sociale ndërmjet Komuniteteve dhe Bashkisë Shkodër është hartuar nga Qendra e Gruas Hapa të Lehtë në kuadër të projektit “Lëvizja Qytetare për Bashkëqeverisje”. Ky produkt është në vazhden e studimeve dhe aktiviteteve që Qendra e Gruas Hapa të Lehtë ka ndërmarrë vitet e fundit, në gjithë rajonin e Veriut përta i përket çështjeve të demokracisë me pjesmarrje dhe rritjes së llogaridhënies nga pushteti lokal.

Kontrata Sociale me Komunitetet, është një proces i nisur vite më parë nga Qendra e Gruas, nën mbështetjen e UN Women, USAID dhe së fundmi Lëviz Albania. Qëllimi kryesor i Kontratës Sociale është përforcimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të komuniteteve lokale në rritjen e kërkesës së llogarisë ndaj pushtetit lokal për të ofruar shërbime më efikase dhe cilësore për qytetarët. Kontrata e fundit Sociale me Komunitet është nënshkruar me 05.12.2015 me kryetaren aktuale të Bashkisë Shkodër Znj. Voltana Ademi.



Model nga Kontrata Sociale, nënshkruar me 05.12.2015 mes Komuniteteve dhe Znj. Kryetare Voltana Ademi

Ne besojmë që perceptimet e qytetarëve për ofrimin e shërbimeve publike janë një instrument i domosdoshëm për ngritjen dhe përmirësimin e tyre. Përdorimi i këtyre perceptimeve është bërë shumë i shpeshtë në kërkimet në fushën e administrimit publik; vlerësimi i performancës së shërbimeve është një nga mënyrat e pakta të disponueshme për të parë sa mirë ofrohen shërbimet në territor.

Më konkretisht, përgjatë periudhës Mars 2016 - Maj 2017, Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" implementoi projektin me titull "Lëvizja Qytetare për Bashkëqeverisje", i cili mbuloi gjithë territorin e Bashkisë së re Shkodër, me 10 Njësi Administrative gjithsej.

Fokusi i këtij aksioni ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve të Shkodrës në rolin e tyre në bashkëqeverisje si dhe monitorimi i Kontratës Sociale dhe detyrimeve të ndërmarra nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër përgjatë kohës së mandatimit.

Për të arritur këtë qëllim, Qendra e Gruas 'Hapa të Lehtë' realizoi 60 takime tematike me komunitetet e 10 Njërive Administrative të Bashkisë Shkodër. Takime të cilat u fokusuan në ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me të drejtën për pjesëmarrje në vendimmarrjen lokale dhe të ushtruarit të së drejtës për të kërkuar llogaridhënie ndaj përfaqësuesve të zgjedhur nga vetë komunitetet.

Pjesë e agjendës së takimeve me komunitet qenë dhe marrja e feedbackut në lidhje me vlerësimin në terma konkrete të performancës së shërbimeve të ofruara nga Bashkia e re dhe nxjerra në pah të pritshmërive të pjesëmarrësve për përmirësimin e këtyre shërbimeve. Specifikisht, objektivat e këtij raporti lidhen me vlerësimin e performancës së disa prej shërbimeve të ofruara nga Bashkia Shkodër, me qëllim evidentimin e komponentëve pozitivë dhe negativë të ofrimit të shërbimeve dhe me identifikimin e pritshmërive të pjesëmarrësve nga këto shërbime.

Gjatë këtyre takimeve Qendra e Gruas Hapa të Lehtë, adresoi dhe nxiti vetë komunitetet të ngrinin zërin dhe të merrnin masa konkrete për zgjidhje për një ose dy probleme që ato vazhdonin t'i konsideronin si prioritarë për zonën e tyre. Problemet e ngritura duhet të ishin pjesë e angazhimeve të marra përsipër nga vetë Kryetarja e Bashkisë Shkodër znj. Voltana Ademi përgjatë nënshkrimit të Kontratës Sociale dhe jo të parashtronin tematika të reja.

Gjatë punës së saj Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" u ndihmua dhe u asistua edhe nga një bord ekspertësh i cili u ngrit në kuadër të këtij projekti me ekspertë të fushave të ndryshme të cilët vlerësuan me prioritet çdo hap të ndërmarë nga Qendra e Gruas në lidhje me implementimin e këtij projekti.

Instrumenti i përdorur për vlerësimin e pikave të Kontratës Sociale dhe shërbimeve ishte pyetësori, me një metodologji sasiore. Numri i pjesëmarrësve që iu përgjigjën pyetësorëve ishte N = 400. Kampionimi ishte i qëllimshëm me kuota, sipas zonave urbane dhe rurale dhe gjinisë.

---

## PAK BACKGROUND TEORIK...

### DECENTRALIZIMI DHE ROLI I PUSHTETIT VENDOR...

Në Korrik të vitit 2014 Kuvendi Shqiptar ka miratuar ligjin për reformën administrative - territoriale, duke e ndarë vendin në 61 njësi. Reforma administrative – territoriale u planifikua dhe po zbatohet në bazë të tre objektivave strategjikë: i) përmirësimi i shërbimeve për qytetarët në nivel vendor, ii) rritja e efijencës dhe mirëqeverisjes në nivel vendor, iii) fuqizimi i qeverisjes vendore, qytetarëve dhe komuniteteve. Qeverisja vendore ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.

Decentralizimi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohet nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Decentralizimi ka përmasat e veta, politike, administrative dhe financiare, të cilat ndërveprojnë midis tyre dhe përfaqësojnë në thelb tre komponentët e pushtetit.

Decentralizimi është politik dhe përfshin transferimin e autoritetit politik në nivelin vendor nëpërmjet një sistemi përfaqësimi të bazuar në zgjedhjet politike vendore. Nëpërmjet decentralizimit administrativ transferohet përgjegjësia për çështjet e administrimit të disa funksioneve publike qendrore të njësitë vendore, ndërsa decentralizimi financiar i referohet zhvendosjes së pushtetit financiar pranë nivelit vendor, me qëllim pajisjen e tij me autoritet më të madh në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Sipas ligjit të ri për vetëqeverisjen vendore një bashki ka disa funksione (përveç atyre të deleguara). Këto funksione i referohen 6 fushave:

1. Infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
2. Shërbimeve sociale; kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
3. Mbrojtjes së mjedisit;
4. Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
5. Zhvillimit ekonomik vendor;
6. Sigurisë publike.

Tradicionalisht, shërbimet publike në vende të ndryshme të botës janë organizuar në formë të tillë që e bëjnë publikun pasiv, si një marrës i një shërbimi të standardizuar. Qeveritë e këtyre vendeve po eksperimentojnë me riprojektimin e sistemit, në mënyrë që qytetarët të kenë mundësi të luajnë një rol aktiv si komunitet përdoruesish i shërbimeve publike. Këto ndryshime mund të lidhen me procese pjesëmarrëse dhe forume, me monitorimin nga komuniteti dhe buxhetimin pjesëmarrës ose me forma të reja të financimit. Teknologjia e informacionit dhe të dhënat e hapura mundësojnë një mënyrë ndryshe për pjesëmarrjen. Në këtë kuadër sot besohet se pjesëmarrja e komunitetit është një domosdoshmëri për rritjen e integritetit publik, përmirësimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin eficient të pasurive kombëtare. Të dhënat për Qeverisje të Hapur i lejojnë çdokujt të aksesojë dhe të

përdorë të dhënat e qeverisë, duke krijuar kështu mundësi të reja pjesëmarrjeje. Raportet e performancës publike janë një pjesë e strategjive për përmirësimin e shërbimeve të ofruara te publiku.

## PJESMARRJA QYTETARE NË PROÇESET E VENDIMARRJES LOKALE...

Pjesëmarrja qytetare nënkupton përfshirjen e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit të mirëqënjes së qytetarëve. Strategjitë e avancuara për pjesëmarrjen publike, promovojnë përgjegjësinë, rrisin besimin dhe forcojnë përkushtimin e vendim-marrësve drejt përmirësimit të qeverisjes dhe kufizojnë praktikën korruptive. Pjesëmarrja qytetare si synim ka bashkërendimin dhe koordinimin e veprimeve në mes institucioneve, shoqërisë civile, sektorit privat dhe publik në përgjithësi. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë dhe respektimit të ligjit në institucionet e shtetit.

Edhe pse pjesëmarrja qytetare është obligim kushtetues dhe ligjor, megjithatë zbatimi i tyre në praktike përcillet me sfida dhe vështirësi. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve kërkon, informacione, aftësi, mjete financiare dhe kohë. Praktika e deritashme ka dëshmuar se qytetarët janë më shumë të interesuar për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale në ato raste kur vendimi prek drejtpërdrejtë interesat e ngushta të tyre, familjes dhe rrethit ku ata jetojnë. Shpesh qytetarët i japin prioritet sigurimit të mbijetesës së familjeve të tyre dhe nuk kanë kohë për angazhim serioz në procesin e qeverisjes lokale. Sigurimi i informacioneve online, përmes web-faqeve dhe formave të tjera elektronike, si: vendimeve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera me rendësi, është një mënyrë alternative e marrjes së informacionit dhe përfshirjes në vendimmarrje.

Qëllimi i pjesëmarrjes qytetare është të promovojë transparencën, të inkurajojë qeverisjen e hapur dhe të krijojë pronësi qytetare në politikat publike. Përveç kësaj, pjesëmarrja publike:

- Krijon hapësirën për vendimmarrje të përbashkët: institucionale - qytetare.
- Rrit njohuritë e qytetarëve në lidhje me mënyrën e funksionimit të institucioneve dhe njëkohësisht krijon mekanizmat për monitorimin e procesit të vendim-marrjes në këto institucione.
- Krijon mundësi publikut për pjesëmarrje në programet dhe projektet zhvillimore.

Bazuar në ligjin Nr. 139, datë 17/12/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", një nga detyrimet kryesore të pushtetit lokal është konsultimi me komunitetet përpara dhe përgjatë çdo procesi vendimmarrës që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë komunitetet lokale. Sic e dimë, kjo praktikë aplikohet pak ose aspak në realitetin tonë. Komunitetet në përgjithësi jo vetëm që janë shumë pak të informuara në lidhje me proceset e vendimmarrjes lokale por dhe kryesisht e shohin veten jashtë këtyre proceseve. Ndaj, lind e nevojshme përforcimi i grupeve ekzistuese me bazë komunitare, me qëllim informimin e tyre në lidhje me përgjegjësitë dhe detyrat e pushtetit lokal por dhe mbi format alternative të kërkesës së llogarisë mbi vendimmarrjen lokale, sidomos tani me ndarjen e re administrative, ku komunitete të tëra janë larg

gjeografikisht. Nga ana tjetër bazuar dhe në experiencën tonë të meparshme persë i përket procesit të nenshkrimit dhe zbatimit të Kontratave Sociale nga Kryetaret e Bashkive perkatese, shihet si domosdoshmeri vazhdimi i këtyre proceseve përmes krijimit dhe fuqizimit të instrumentave të lobimit dhe keshillimit të vendimarrjes lokale nga aktore aktive në komunitetet, të cilët kanë njohuri të mirë të territorit, kanë dëshirë për t'u angazhuar në nisma qytetare dhe mbi të gjitha janë apolitik. Projekti ka synuar të fuqizojë komunitetet sidomos ato që janë larg gjeografikisht qytetit dhe të rrisë dialogun me pushtetin lokal, institucionet vendore dhe aktore të tjera të shoqërisë civile që kanë ndermarre përsiper iniciativë të ngjashme, përmes nxitjes së proceseve me baze komunitare, nxitjes së monitorimit, vlerësimit dhe rritjes së kërkesës së llogarise së këtyre grupeve ndaj vendimarrjes lokale.

## PËRDORIMI I PERCEPTIMEVE TË QYTETAREVE SI MJET PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Efektet e reformave në sektorin publik mund të analizohen në formë të ndryshme. Sipas studimeve, një numër i madh reformash bazohen në mendimet e zyrtarëve publikë dhe vlerësimet e përgjegjësve për reformat. Logjika prapa përdorimit të një vetë – vlerësimi të tillë lidhet me faktin se zyrtarët, politikanët dhe përgjegjësit mund të konsiderohen ekspertë dhe të kenë eksperiencë të madhe në këtë drejtim. Aktualisht, përdorimi i perceptimeve të qytetarëve po bëhet shumë i shpeshtë në kërkimin në administrimin publik kryesisht për të vlerësuar performancën e shërbimeve publike. Individët, grupet dhe komunitetet mund të përfshihen në kërkime dhe vlerësime si:

- Përdorues të shërbimeve – në lidhje me eksperiencën e tyre dhe nevojat për zhvillimin e shërbimeve që përdorin ose jo;
- Taksapagues – në lidhje me shpërndarjen e burimeve ose balancën mes cilësisë dhe sasisë së shërbimeve që ofrohen dhe kostove që kanë;
- Qytetarë – në lidhje me çështje që mund t'i ndikojnë drejtpërdrejtë si p.sh. zhvillimet që ndodhin në komunitetin ose lagjen e tyre. Gjithashtu, mund të lidhen dhe me aspekte të ndryshëm të zhvillimeve të politikave, të cilat mund të kenë një ndikim në popullatën më të gjerë në fushë si shëndetësia, edukimi dhe politikat e mirëqenies.

Në përgjithësi kërkimi në fushën politike ka qenë ambivalent në lidhje me përdorimin e mendimeve të qytetarëve për qeverisjen, pasi jo gjithmonë qytetarët janë të mirë – informuar, ndërsa marrëdhënia mes performancës së përmirësuar të qeverisjes dhe perceptimeve publike më pozitive nuk është aspak e drejtë. Ekziston një debat aktiv për ndryshimet mes përdorimit të vlerësimeve objektive apo subjektive ose ndërmjet të dhënave të gjeneruara nga agjencitë apo nga qytetarët, si dhe për faktorët e përmbajtjes dhe të metodologjisë që përcaktojnë këto perceptime. Megjithatë, vlerësimet e qytetarëve kanë qenë shumë të dobishme dhe të besueshme kur janë përdorur për të vlerësuar shërbimet publike. Një avantazh tjetër është se përdorimi i perceptimeve të qytetarëve shpeshherë është një nga mënyrat e pakta të disponueshme për të vlerësuar rezultatet e shërbimeve. Ai ndihmon gjithashtu për të kapërcyer kritikizmin për zgjedhjen artificiale të një tërësie objektivash dhe indikatorësh nga vetë institucionet përgjegjëse. Nga ana tjetër, nuk duhen përdorur vetëm perceptimet e qytetarëve si mënyra e vetme e vlerësimit të performancës, pasi qytetarët nuk e vlerësojnë shërbimin bazuar në një tërësi informacionesh, ata bazohen më shumë në përvojën personale ose në ato që dëgjojnë.

---

## METODOLOGJIA

### OBJEKTIVAT E RAPORT MONITORIMIT:

1. Krijimi i një panorame të përgjithshme mbi ecurinë e zbatimit të pikave të Kontratës Sociale në vitin e 3-të të Qeverisjes dhe propozimi i rekomandimeve mbi përshpejtimin e procesit të realizimit të premtimeve.
2. Vlerësimi i nivelit të angazhimit dhe identifikimi i sfidave në lidhje me pjesmarrjen e qytetarëve dhe të shoqërisë civile në nivel lokal.
3. Identifikimi i prioriteteve dhe nxitja e dialogut ndërmjet shoqërisë civile, komuniteteve dhe pushtetit lokal.

### PËR TË REALIZUAR KËTË RAPORT MONITORIMI, GRUPI I PUNËS PËRDORI MJETET E MËPOSHTME TË HULUMTIMIT:

1. Administrim i pyetsorit mbi performancën e shërbimeve publike të ofruara nga Bashkia Shkodër në 10 Njësi Administrative.
2. Intervista të drejtpërdrejta me focus grupe me përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë të thjeshtë dhe eksperte e aktorë të fushave të ndryshme në qytet.
3. Vrojtim në terren dhe vrojtim i faqeve online të Njësive të Qeverisjes Vendore mbi ecurinë e zbatimit të pikave të Kontratës por jo vetëm.




---

## GJETJE DHE KONKLUSIONE...

Për të qënë sa më e saktë në vlerësimin e saj Qendra e Gruas hartoi dhe shpërndau 40 pyetësor për cdo Njësi Administrative. Pyetjet e pyetësorit janë hartuar në bazë të pikave të Kontratës Sociale, metodologji sasimore ku për secilen pikë u hartuan 3 pyetje. Nga përpunimi i këtyre të dhënave rezultoi se:

Gjithsej morën pjesë **400 qytetarë**, prej të cilëve:

51% Femra dhe 49% Meshkuj



29% të moshës 18 – 30 vjec, 30% të moshës 31 – 45 vjec, 24% të moshës 46 – 60 vjec, 18% të moshës mbi 60 vjec

37% të punësuar dhe 63% të papunësuar


31% me nivel arsimor 9-vjecar, 24% nivel arsimor i mesëm i përgjithshëm, 14% I mesëm profesional, 28% nivel arsimor universitar, 4% nivel arsimor pasuniversitar

## PERCEPTIME MBI ZBATIMIN E PIKAVE TË KONTRATËS SOCIALE

### 1. NXITJA E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJEN E KOMUNITETIT LOKAL, TË CILËT DO TË PËRCAKTOJNË PRIORITETET NË PËRDORIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURIMEVE FINANCIARE.

- (1) 73% nuk kanë aspak njohuri në lidhje me planifikimin e buxhetimit me pjesëmarrje nga Bashkia, 13% kanë pak njohuri, 4% nuk e dinë, 6% kanë disi njohuri dhe 4% kanë shumë njohuri
- (2) 6% kanë qene pjesë e takimeve për miratimin e buxhetit dhe 94% nuk kanë qene kurre pjesë
- (3) 33% e atyre që kanë qene pjesë e takimeve konsultative shprehen që nuk u janë vënë në zbatim sugjerimet e tyre dhe vetëm 8% shprehen se ju janë marrë në konsideratë.


*KONKLUZION: 73% e kampionit shpreh se nuk ka aspak njohuri mbi çështjet e buxhetimit me pjesëmarrje, ndërkohë 94% e tyre shprehen se nuk kanë qënë asnjehere pjesë e planifikimit dhe diskutimit të buxhetit.*



### 2. FUQIZIMI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE, PËRGATITJA DHE PËRDITËSIMI I PLANIT SOCIAL TË ZONËS SI INSTRUMENT BAZË I VLERËSIMIT TË NEVOJAVE, PLANIFIKIMIT, REALIZIMIT E MONITORIMIT TË VAZHDUESHËM TË SHËRBIMEVE SOCIALE.

- (1) 37% nuk janë aspak të kënaqur me shërbimet sociale që ofron Nj. A tyre, 27% janë pak të kënaqur, 3% kanë dhënë përgjigjen nuk e di, 18% janë disi të kënaqur dhe 15% janë shumë të kënaqur

## Shkalla e kënaqësisë nga Shërbimet Sociale të ofruara




- (2) 38% janë aspak të kënaqur me mënyrën e adresimit të nevojave të tyre nga Administratori i Nj. A., 25% janë pak të kënaqur, 3% janë përgjigjur me nuk e di, 15% janë disi të kënaqur dhe 19% janë shumë të kënaqur
- (3) 23% janë përgjigjur me aspak pyetjes nëse një administrator femër do të rriste cilësinë e shërbimeve, 23% janë përgjigjur pak, 24% janë përgjigjur nuk e di, 16% disi dhe 14% shumë.

**KONKLuzion:** Në lidhje me sektorin e Shërbimeve Sociale, banoret ndahen 50 me 50, nga ku 37% shprehen se nuk janë aspak të kënaqur me shërbimet sociale që ofron Nj. A tyre, ndërkohë përreth 33% shprehen se janë të kënaqur dhe shumë të kënaqur.

### 3. NGRITJA E NJË QENDRE TË MBROJTUR "STREHËZ PËR FAMILJEN" NË KUSHTET E EMERGJENCËS SOCIALE TË DHUNËS NË FAMILJE.

- (1) 52% janë përgjigjur që kanë aspak informacion për shërbimin antidhunë që ofrohet në Nj. A., 20% kanë pak informacion, 13% nuk e di, 9% disi dhe 7% kanë shumë informacion.
- (2) 71% nuk kanë aspak dijeni për ekzistencën e një strehëze në ndihmë të viktimave të dhunës në familje, dhe vetëm 29% janë në dijeni të këtij shërbimi.

## Njohuri për Strehëzën për Familjen




- (3) 29% mendojnë që strehimi për 3 ditë në qendër nuk ka aspak ndikim pozitiv, 30% ka pak, 11% nuk e di, 26% disi dhe 4% shumë ndikim pozitiv

**KONKLuzion:** Në lidhje me çështjen e ngritjes së një Qendre të mbrojtur "Strehëz për Familjen" në kushtet e emergjencës sociale të dhunës në familje pranë Bashkisë Shkodër por jo vetëm edhe në lidhje me decentralizimin e këtij shërbimi në nivel Nj.A të dhënat paraqiten si më poshtë: 52% e kampionimit shprehet se nuk kanë aspak informacion me shërbimin antidhunë që ofrohet në Nj. A të tyre. Ndërkohe, kur pyeten për njohjen mbi ekzistencën e një streheze emergjence në Bashkinë Shkodër, 41% e tyre shprehen se nuk kanë aspak dijeni për ekzistencën e një strehëze në ndihmë të viktimave të dhunës në familje dhe përreth 50% mendojnë se strehimi vetëm 3 ditë ka pak dhe aspak ndikim në përmiresimin e situatës së gruas.

**4. PROMOVIMI DHE NXITJA E HAPJES SË STRUKTURAVE TË EDUKIMIT, TË SHKOLLAVE PUBLIKE JASHTË ORARIT MËSIMOR, NË MBËSHTETJE TË SHËRBIMEVE SOCIALE KOMUNITARE DHE PËR TË PLOTËSUAR NJË NGA TË DREJTAT BAZË TË FËMIJËVE SIC ËSHTË ARGËTIMI, LOJA, MUZIKA, SPORTI, ETJ.**

(1) 70% janë aspak të kënaqur me shërbimet sociale për fëmijë që ofrohen pas orarit mësimor, 17% janë pak të kënaqur, 4% nuk e di, 6% disi dhe 3% shumë




(2) 98% mendojnë se shërbimet për fëmijë duhen shtuar, 2% mendojnë jo

(3) 83% mendojnë që bashkia Shkodër nuk ka përmirësuar aspak infrastrukturën në lidhje me ndërtimin e ndonjë qendre kulture, fushe sportive, në shërbimet për fëmijë, 7% mendojnë që është bërë pak në këtë fushë, si Dajci, 4% nuk kanë informacion, 3% mendojnë disi, 3% mendojnë shumë.

**KONKLuzion:** Në lidhje me shërbimet socio-kulturorë që duhet të ofrojë Bashkia Shkodër në Nj.A, 71% e popullatës së kampionimit shprehet se nuk janë aspak të kënaqur me shërbimet sociale për fëmijë që ofrohen pas orarit mësimor, 98% mendojnë se shërbimet për fëmijë duhen shtuar dhe 83% deklarojnë që Bashkia Shkodër nuk ka përmirësuar infrastrukturën në lidhje me ndërtimin e ndonjë qendre kulture, fushe sportive, në shërbimet për fëmijë në Nj.A përreth.

**5. KRIJIMI I NJË TËRRITORI URBAN SHUMË-QENDËRSH PËRMES FORCIMIT TË AKSESIT DHE KONSOLIDIMIT TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE DHE TRANSPORTIT PUBLIK.**

- (1) 63% mendojnë që shërbimi ndërrurban nuk është përmirësuar aspak, 14% mendojnë pak, 1% nuk kanë informacion, 21% disi dhe 1% shumë




- (2) 34% mendojnë se nuk ka aspak përmirësime në sinjalistikë, 41% mendojnë se ka patur pak përmirësime, 2% nuk kanë informacion, 18% mendojnë disi dhe 6% mendojnë shumë.
- (3) 41% janë përgjigjur që nuk ka aspak investime në infrastrukturë (asfaltim), 40% janë përgjigjur pak, 1% nuk kanë informacion, 17% mendojnë disi, dhe 1% mendojnë shumë

*KONKLUZION: Shumica e kampionimit shprehet e pakënaqur në lidhje me përmirësimin e shërbimit ndërrurban në Bashki (përreth 63%), 75% mendojnë se nuk ka pasur përmirësime në sinjalistikë dhe 80% e popullatës së kampionuar shprehet se investimet në infrastrukturë janë të pakta.*

## 6. MBËSHTETJA E AKTIVITETEVE BUJQËSORE/BLEGTORALE DHE INTEGRIMIN E TYRE ME MUNDËSI PËR TË NXITUR ZHVILLIMIN E EKO-TURIZMIT.

- (1) 17% mendojnë që po ofrohet treg për shitjen e produkteve bujqësore/blegtorale në Nj.A e tyre, 83% mendojnë që jo, nuk ofrohet treg.




- (2) 20% janë përgjigjur që po ka patur projekte për pastrim/ rregullimin e kanaleve vaditëse/ujitëse, 80% janë përgjigjur jo.
- (3) 59% janë përgjigjur që nuk ka patur projekte të zbatuara në eko-turizem, 11% janë përgjigjur pak, 26% nuk kanë informacion, 4% disi dhe 1% shumë.

**KONKLuzion:** 83% e kampionimit shprehet se akoma nuk ka tregje për shtijen e produkteve blegtorale dhe bujqësore, po kaq shprehen së nuk kanë pare projekte konkrete për pastrim/ rregullimin e kanaleve vaditëse/ujitëse.

## 7. ZGJERIMI DHE PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE NË UJËSJELLËS-KANALIZIME, PAS KRYERJES SË NJË STUDIMI TË HOLLËSISHËM TË SITUATËS NË KËTË SEKTOR.

- (1) 55% janë përgjigjur që nuk ka patur aspak përmirësime në cilësinë e shërbimeve në ujësjellës, 27% janë përgjigjur pak, 2% nuk kanë informacion, 14% disi dhe 3% janë përgjigjur shumë




- (2) 64% janë përgjigjur që nuk ka patur aspak rritje të cilësisë së ujit, 21% pak, 4% nuk kanë informacion, 11% disi dhe 1% janë përgjigjur shumë.
- (3) 78% janë përgjigjur që nuk ka patur aspak përmirësime në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza, 8% janë përgjigjur pak, 6% nuk kanë informacion, 7% disi është punuar, 2% janë përgjigjur është punuar shumë.

**KONKLuzion:** Në lidhje me zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në ujësjellës-kanalizime, 55% e kampionimit shprehen që nuk ka patur aspak përmirësime në cilësinë e shërbimeve në ujësjellës, 78% janë përgjigjur që nuk ka pasur përmirësime në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza dhe diku 64% dekalorojnë që nuk ka pasur rritje të cilësisë së ujit.

## 8. NXITJA E ZHVILLIMIT TË EKUILIBRUAR TË TURIZMIT DHE RITJIA E VLERËS SË TERRITORIT SI DESTINACION TURISTIK, DUKE FORCUAR IDENTITETIN UNIK KULTUROR, SOCIAL, MJEDISOR E EKONOMIK DHE BURIMET NJERËZORE.

- (1) 2% janë përgjigjigjur që Nj A e tyre nuk është përfshirë aspak si destinacion turistik, 17% janë përgjigjigjur pak, 31% nuk e dinë, 16% disi dhe 5% janë përgjigjigjur që Nj A e tyre është përfshirë shumë si destinacion turistik
- (2) 40% janë përgjigjigjur që Bashkia nuk ka promovuar aspak vlerat turistike të Nj A së tyre, 27% mendojnë pak janë promovuar, 24% nuk e dinë, 9%disi dhe 1% shumë.
- (3)




- (4) 37% janë shprehur se Bashkia nuk ka ndërmarrë aspak projekte për ruajtjen e vlerave turistike të Nj. A të tyre, 15% janë përgjigjigjur pak, 34% nuk kanë informacion, 14% disi dhe 0% shumë

*KONKLuzion: Në lidhje me nxitjen e zhvillimit të ekuilibruar të turizmit dhe rritja së vlerës së territorit si destinacion turistik, 40% janë përgjigjigjur që Bashkia nuk ka promovuar vlerat turistike të Nj.A së tyre dhe 37% e tyre shprehen se Bashkia nuk ka ndërmarrë projekte për ruajtjen e vlerave turistike të Nj. A të tyre.*

**9. PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE, SHTRIRJA E TIJ NË TË GJITHË TERRITORIN E BASHKISË SI DHE ORGANIZIMI I MBLEDHJES SË DIFERENCUAR TË MBETJEVE PËR TË MUNDËSUAR DHE STIMULUAR TRAJTIMIN E MBETJEVE (RICIKLIMIN DHE KOMPOSTIMIN).**

- (1) 48% janë shprehur që nuk janë aspak të kënaqur me grafikun e pastrimit të mbeturinave në Nj. A e tyre, 15% pak, 0% nuk e dinë, 28% disi dhe 9% shumë.
- (2) 3% janë shprehur po Bashkia ka vënë kosha për diferencimin e mbetjeve, 97% janë shprehur jo.
- (3) 43% janë shprehur që nuk ka aspak mjaftueshëm kosha mbeturinash në Nj. A e tyre, 15% pak, 5% nuk kanë informacion, 26% disi dhe 12% shumë

## Shkalla e kënaqësisë nga shërbimi i pastrimit të mbeturinave



**KONKLuzion:** Në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, shtrirjen e tij në të gjithë territorin e Bashkisë, perceptimet e qytetarëve janë si mëposhtë: 53% janë shprehur që janë pak ose aspak të kënaqur me grafikun e pastrimit të mbeturinave në Nj. A e tyre dhe me numrin e koshave në dispozicion për Nj.A; 97% e popullatës së kampionit shprehet se nuk ka diferencim të mbetjeve

## PERFUNDIME DHE REKOMANDIME...

Perceptimet e publikut për vlerësimin e performancës së shërbimeve të ofruara nga pushteti vendor janë të rëndësishme së pari, për informimin e Bashkive për cilësinë në ofrimin e shërbimit, por edhe për projektimin e ndërhyrjeve të ardhshme për përmirësimin e tyre. Ky raport ka synuar jo vetëm të evidentojë performancën aktuale të shërbimeve të ofruara nga pushteti vendor dhe sektorëve përkatës, por edhe të sjell në pah pritshmëritë dhe kërkesat e pjesëmarrësve që besonin se këta sektorë duhet të përmirësoheshin.

Në përfundim të kërkimit u vu re se Bashkia Shkodër ofron disa shërbime me performancë të mirë, mes të tjerash veçohen promovimi i turizmit në zonat Gur i Zi, Velipoje, Thethe, Postribe e tj. Perforcimi i shërbimit social në qendrat komunitare për familjen në Nj. A Dajc dhe 4 në qytetin e Shkodrës.

Nga ana tjetër, Bashkia Shkoder ka nevojë për të përmirësuar disa nga shërbimet që ofron ose sektorët përkatës, prej të cilëve ata që kanë rezultuar me më shumë nevojë për përmirësim ishin sektori i ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, i menaxhimit të mbetjeve urbane dhe pastrimit të kanaleve ujëtare dhe kulluese.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se në të shumtën e rasteve ka konfuzion ndërmjet pjesëmarrësve për ndarjen e kompetencave, gjë që mund të çojë në mungesën e qartësisë së tyre për të kërkuar një shërbim. Studimet tregojnë se mungesa e informimit të saktë të qytetarëve për një tërësi shërbimesh dhe nismash çon në vlerësime të anshme të tyre.

Gjatë realizimit të kërkimit është bërë përpjekje për të eksploruar prirjet e banorëve të zonave të ndryshme dhe me tipologji të ndryshme. Në këtë kuadër, i është kushtuar rëndësi kryesisht banorëve të zonave rurale, të atyre territoreve dhe komuniteteve që kanë filluar të marrin shërbimet nga Bashkia



Shkodër pas reformës administrative – territoriale. Përpos këtyre, të dhënat demografike të pjesëmarrësve (si gjinia, mosha, statusi civil dhe arsimi) janë përdorur për të evidentuar dhe grupet e pjesëmarrësve që kërkojnë më shumë përmirësime të shërbimeve, në përpjekje për të kuptuar se ku mund të orientohen dhe investojnë shërbimet/sectorët në një të ardhme.

Në këtë kuadër, kryesisht banorët e zonave të reja dhe banorët e zonave rurale besojnë se shërbimet përkatëse dhe sektorët që i ofrojnë kanë nevojë për përmirësim. Shpeshherë, banorët e zonave rurale, pra të Nj.A rezultojnë me diferencë të konsiderueshme në kërkesat e tyre për përmirësimin e shërbimeve, si p.sh. në rastin e mirëmbajtjes së rrugëve, në rastin e menaxhimit të mbetjeve urbane, në rastin e ujitjes dhe kullimit, planifikimit urban, organizimit të aktiviteteve çlodhëse dhe argëtuese dhe përmirësimin e hapësirave publike. Sic duket, pavarësisht përpjekjeve për të zgjeruar aksesin territorial ndaj shërbimeve, akoma shërbime të caktuara mbesin të centralizuara në nivel qendror Bashkie dhe qytetare të zonave të thella gjeografike, e kanë të vështirë të marrin informacionin ashtu dhe aksesin ndaj shërbimeve specifike. Në këtë linjë janë vlerësuar dhe komponentët e procesit të marrjes së një shërbimi, që mund të lidhen me mjedisin, rregullat ose me burimet njerëzore. Ndër komponentët e vlerësuar më pozitivisht ishin komunikimi i stafit dhe mirësjellja e tij. Vlerësimet negative të pjesëmarrësve lidheshin me kushtet, si vendet për t'u ulur, dhe me rregullat, si oraret e pritjes dhe koha për t'a marrë shërbimin. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, një parim i rëndësishëm është dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procese vendimmarrëse. Për ta matur nivelin e pjesëmarrjes është përdorur një pyetje e drejtëpërdrejtë, e pasuar nga një tjetër që u kërkonte pjesëmarrësve të sugjeronin hapa konkretë për përmirësim. Është tregues i rëndësishëm fakti se dy të tretat e pjesëmarrësve mendonin se duhet të përmirësohet pjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje, nëpërmjet konsultimit më të madh me të, dhe marrjes parasysh të mendimeve të qytetarëve.

## REKOMANDIME

- (1) *Më konkretisht rekomandohet: Në lidhje me ceshtjet e buxhetimit me pjesëmarrje të komunitetit lokal, të ketë përfaqësueshmeri me të larte të territoreve të Njësive Administrative, sidomos kur takime të tilla bëhen në Shkodër qytet. Gjithashtu rekomandohen perdorimi i metodave alternative që janë më afër qytetareve të zonave të Nj.A te tilla si lajmerimi në kryeqendren e fshatit apo komunes, lajmërimi përmes përfaqësuesit të Nj.A, permes Tv lokale e kështu me rrallë. Në të shumtën e rasteve qytetarët e këtyre zonave nuk kane akses ndaj internetit, informacionit por edhe kur u ofrohet ky akses nuk kane njohuri të mjaftueshme se si te hulumtojne informacionin. Ndaj, sugjerohet perdorimi i metodave tradicionale.*
- (2) *Sektori i shërbimeve sociale, paraqitet mirë në përceptimin e qytetareve. Kërkohet vetem zgjerim territorial dhe decentralizim i shërbimeve prane territorit sidomos zonave të largëta gjeografike.*
- (3) *Informacioni në lidhje me kompetencat dhe shërbimet që duhet të ofrojë Bashkia në lidhje me Viktimat e Dhunës në Familje është i pakët, sidomos në zonat periferike. Bashkia Shkodër duhet të rrise përpjekjet mbi ndërgjegjësimin dhe informimin e popullatës për këtë shërbim që aktualisht ofron më së miri. Sugjerohet decentralizim i shërbimit në të gjitha Nj.A.*
- (4) *Në lidhje me shërbimet sociale, edukuese dhe kulturore për fëmijë që konisderohen tepër të pakta, kërkohet rritja e fondeve në këtë fushe me qëllimin përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve në nivel Nj. A. Fëmijëve të fshatrave të NJ.A u ofrohen pak dhe aspak shërbime të tilla, të rëndesishme për mirërritjen dhe cilësinë e jetës se tyre.*
- (5) *Përsa i përket shërbimit ndër-urban në infrastrukturën rrugore dhe të transportit publik, akoma kërkohet vëmendje dhe alokim fondesh me teper nga Bashkia për përmirësimin e këtyre shërbimeve.*
- (6) *Në qytet por edhe në NJ.A përreth akoma mungojne tregjet e shitjes. Grupimi i zonave të përafërta dhe ndërtimi i tregjeve me kosto të ulet në bashkëpunim me privatin, mund të shihet si një zgjidhje e mundshme.*
- (7) *Edhe pse Bashkia Shkodër ka ndërmarre inisiativa në lidhje me zgjerimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në ujësjellës-kanalizime, këto inisiativa mbeten të pakta dhe të padukshme në syte e qytetarëve. Shpeshhere kjo shpjegohet me mungesen apo moskalimin e informacionit për investimet që bën Bashkia tek qytetarët.*
- (8) *Në lidhje me nxitjen e zhvillimit të ekuilibruar të turizmit dhe rritjes së vlerës së territorit si destinacion turistik, sugjerohet më tepër pune dhe përfaqësueshmeri të të gjithë territoreve të reja që mbulon Bashkia Shkodër dhe jo vetem fokusim në zona të caktuara.*
- (9) *Së fundmi, në lidhje me përmirësimin e cilësisë së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, dhe shtrirjes së tij në të gjithë territorin e Bashkisë si dhe organizimi i mbledhjes së diferencuar mbetet akoma problem sidomos në zonat e thella gjeografike por edhe në qytetet. Kërkohet nga Bashkia vëmendje me e madhe ndaj kësaj çështje, e cila paraqitet si tepër problematike nga qytetarët.*

Maj, 2017